

Vendim nr. 55, datë 06.05.2026
(V- 55/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Asim Vokshi, Marjana Semini, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 30.04.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (Dh) 2025 të Regjistrit Themeltar që u përket:

KËRKUES:

DHIMË QURKU

ANASTASIA QURKU

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, përfaqësuar nga drejtoresha e departamentit ligjor Fatjola Halilaj.

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Valbona Legisi, Irma Qosja dhe Denisa Skënderaj.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimeve nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2025-709, datë 19.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE:

Nenet 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkesve Dhimë Qurku dhe Anastasia Qurku (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (*OSHEE*) dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit janë trashëgimtarët (prindërit) e shtetasit Edmond Qurku, i cili në datën 18.02.2016 ka qenë duke punuar për montimin e një tende në një apartament që ndodhet në rrugën kryesore “Butrint-Kanali i Çukës”. Gjatë manovrimit të tendës, për shkak të kontaktit të një tubi me gjatësi 6 metër, që e mbante nën sqetull, me linjën ajrore të ndërtuar në shtyllat e tensionit 10 kV, të ndodhur përballë banesës, shtetasit Edmond Qurku i është shkaktuar vdekja e menjëhershme. Organi i prokurorisë në bazë të të dhënave ka arritur në përfundimin se fakti i ndodhur nuk parashikohej si vepër penale dhe, në këto kushte, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

2. Kërkuesit jetonin në një ekonomi familjare me djalin e tyre dhe, nisur nga rrethanat e ngjarjes së rëndë, kanë pretenduar se shkak i humbjes së jetës ka qenë mosrespektimi i rregullave dhe mosmarrja e masave të nevojshme nga OSHEE-ja për të parandaluar dëmet që shkaktohen nga kontakti i padëshiruar me përcjellësit elektrikë ajrorë. Për këtë arsye, ata i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e OSHEE-së të paguajë dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror, në formën e dëmit biologjik, moral dhe ekzistencial në shumën 23.702.270 lekë

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2018-704(339), datë 23.04.2018, ka vendosur: i) pranimin e kërkesëpadisë; ii) detyrimin e OSHEE-së të dëmshpërblejë kërkuesit për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar si rezultat i ngjarjes së datës 18.02.2016, me pasojë vdekjen e shtetasit Edmond Qurku, në shumën totale 23.702.270 (njëzet e tre milionë, shtatëqind e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka arsyetuar se OSHEE-ja i ka vendosur përcjellësit elektrikë në rrugën “Turizëm-Kanali i Çukës” në shkelje të rëndë të distancave të lejuara në objektin e banimit. Gjatë gjykimit të çështjes, për shkak të karakterit teknik të problematikës, është thirrur edhe një ekspert inxhinier elektrik. Sipas mendimit të ekspertit, lartësia e shtyllave që mbanin përcjellësin elektrik dhe distanca nga përcjellësi te godina ishin në shkelje të largësisë së lejuar sipas pikave 11.2. dhe 5.5. të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit dhe rregullores së Sigurimit Teknik, që parashikon se në vendet e banuara linjat elektrike ajrore (në gjendje të qetë) duhet të jenë 10 metra distancë nga objektet e banimit, por, në rastin konkret, largësia

horizontale ishte 1.98-2 metra. Nëse largësia do të ishte sipas normës së lejuar, ai nuk do të kishte mundësi kontakti me rrymën elektrike. OSHEE-ja kishte për detyrë të kontrollonte të gjithë linjën elektrike për siguri, si dhe të vendoste në zonë e në shtyllë tabela sinjalizuese të rrezikut. Gjithashtu, sipas gjykatës së shkallës së parë, OSHEE-ja (bazuar në aktin e ekspertimit elektrik) është përgjegjëse që nuk ka vendosur linjat e tensionit 10 kV në distancat e lejuara të parashikuara nga rregullorja e Kushteve Teknike të Projektimit e vitit 1978 dhe nga rregullorja e Sigurimit dhe e Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalacionet Elektrike, e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 148, datë 09.12.1967, në raport me objektet e banimit, posaçërisht me pallatin ku ka ndodhur ngjarja e rëndë. Nëse linja elektrike do të ishte vendosur në largësinë e lejuar, bazuar në rrethanat e ngjarjes, nuk do të ekzistonte asnjë mundësi potenciale që tubi që mbante nën sjetull i ndjeri Edmond Qurku të prekte përcjellësin ajror elektrik. Në këto rrethana është provuar se pala e paditur/OSHEE-ja ka pasur faj (*shih faqet 5-15 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*). Gjatë gjykimit, për të provuar dëmin moral dhe dëmin ekzistencial, është thirrur edhe eksperti psikologjik që ka vlerësuar se familjarëve u është shkaktuar një dëmtim i konsiderueshëm nga pikëpamja sociale, familjare dhe psikologjike.

4. Ndaj vendimit ka paraqitur ankim OSHEE-ja. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 23-2018-704 (339), datë 23.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Apelit Gjirokastër ka arsyetuar se është e vërtetë që OSHEE-ja nuk ka respektuar distancën 6.5 metra sipas ekspertit të shkallës së parë dhe 2.5 metra sipas ekspertit B.R. (të caktuar nga gjykata e apelit), por edhe nëse do të zbatoheshin largësitë e përcaktuara nga ekspertët dhe do të kishte pasur erë, përsëri do të kishte ndodhur aksidenti, për shkak të pakujdesisë së viktimës (*shih faqen 16 të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër*).

5. Në datën 20.02.2020 kërkuar kanë ushtruar rekurs, ndërsa në datën 17.02.2025 kanë paraqitur parashtrime/shpjegime rreth shkaqeve të paraqitura në rekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-709, datë 19.02.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit. Sipas Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë: (i) Gjykata e Apelit Gjirokastër ka respektuar normat procedurale, të cilat mund të çojnë në pavlefshmërinë e vendimit gjyqësor ose të procedurës së gjykimit. Nuk rezulton të ketë shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit; (ii) palëve iu është dhënë mundësia të realizojnë të drejtën e tyre të mbrojtjes, të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, të debatojnë për to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes; (iii) Gjykata e Apelit Gjirokastër ka respektuar dhe zbatuar drejt dispozitat e ligjit material. Kjo gjykatë ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe të rrethanave që lidhen me mosmarrëveshjen, ka kryer një analizë juridike të plotë të provave dhe e ka zgjidhur mosmarrëveshjen në përputhje me

dispozitat ligjore në fuqi; (iv) vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk bie në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 17.06.2025 kërkesit, nëpërmjet shërbimit postar, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 04.07.2025. Kolegji i Gjykatës, gjatë shqyrtimit paraprak, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar se gjatë procesit gjyqësor është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

7.1.1. *E drejta e aksesit*, pasi gjatë gjykimit në gjykatën e apelit janë paraqitur pretendime se linja elektrike në vendin e ngjarjes ishte në shkelje të nenit 11.2. të rregullores së Kushteve Teknike dhe Projektimit, si dhe për mungesën e një table lajmëruese sipas nenit 5.34. të rregullores së Sigurimit Teknik, por ajo gjykatë ka heshtur për të gjitha kërkimet dhe nuk ka dhënë përgjigje nëse vendosja e linjës elektrike ishte në përputhje me rregulloret dhe me ligjin e urbanistikës. Të gjitha pretendimet e parashtruara ishin në funksion të mbrojtjes të së drejtës kushtetuese të jetës, së drejtës për familje dhe së drejtës për një mjedis të sigurt, pasi jeta e të afërmit të tyre është privuar sepse punonte në një mjedis të pasigurt, për shkak të shkeljeve. Të gjitha këto pretendime nuk janë analizuar nga gjykata e apelit. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij nuk ka cituar as formalisht pretendimet, duke shkelur të drejtën për të pasur një vendim të arsyetuar.

7.1.2. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi gjykata e apelit, megjithëse ka urdhëruar kryesisht përsëritjen e hetimit gjyqësor, nuk ka arsyetuar se përse pretendimi i ngritur nga kërkesit për vendosjen pa leje të linjës elektrike nuk përbën një veprim të paligjshëm me pasojë vdekjen nga kontakti elektrik. Gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve se linja elektrike 10 kV ka shkelur nenin 11.2. të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit, që detyron OSHEE-në ta vendosë linjën 10 metra larg objekteve të banimit dhe se nuk ka pasur asnjë tabelë paralajmëruese për rrezikun nga afërsia e telave elektrike me pallatin. Pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material u

parashtruan edhe në rekurs, por Gjykata e Lartë, megjithëse i ka rreshtuar si shkaqe, nuk u ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve, duke krijuar dyshime të arsyeshme se ka neglizhuar trajtimin e tyre.

7.1.3. *E drejta për ankim substancial dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në vendimin e gjykatës së apelit nuk gjendet asnjë arsyetim, qoftë edhe refuzues, se përse pretendimet e ngritura për vendosjen e linjës elektrike pa leje nga organet e pushtetit lokal për moszbatimin e masës së sigurimit teknik dhe moszbatimin e rregullores së Sigurimit Teknik nuk përbëjnë veprime të paligjshme që kanë sjellë, si pasojë, vdekjen. Mungesa e një arsytimi refuzues është e barabartë me situatën sikur kërkuesit nuk kanë qenë asnjëherë të pranishëm në procesin gjyqësor. Gjykata e Lartë, duke u bazuar edhe në natyrën e pretendimeve, duhet të jepte përgjigje të arsyetuar.

7.2. *E drejta e jetës*, e garantuar në nenin 21 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Apelit Gjirokasër ka lejuar shkeljen e kësaj të drejte duke shpërfilluar detyrimin ligjor që kishte OSHEE-ja, e cila, përpara se të montonte një rrjet elektrik 10 kV në një zonë të banuar, duhej të pajisej me leje ndërtimi. Megjithëse gjykata e apelit është vënë në dijeni zyrtarisht nga Bashkia e Sarandës se linja elektrike në atë zonë banimi është vendosur nga OSHEE-ja pa pasur leje ndërtimi, ajo nuk e ka çmuar këtë fakt të paligjshëm, me pasojë fatale për viktimën. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e apelit nuk ka respektuar dhe nuk ka mbrojtur të drejtën e jetës. Edhe Gjykata e Lartë ka lejuar *cenimin e së drejtës së jetës*, duke arsyetuar se subjekti që shfrytëzon atë linjë elektrike nuk ka asnjë përgjegjësi ligjore për vdekjen.

7.3. *E drejta për familje*, e garantuar në nenin 53 të Kushtetutës, pasi çdo qytetar gëzon të drejtën për të pasur familje. Gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se ngjarja fatale ka cenuar edhe të drejtën për të pasur jetë të qetë familjare, duke shkatërruar marrëdhënien prind-bir. Gjykata e apelit nuk ka arsyetuar se përse është lejuar OSHEE-ja të shfrytëzojë atë rrjet elektrik në kundërshtim me çdo normë ligjore. Askush nuk mund të jetë i sigurt në të ardhmen, pasi familja e tij mund të cenohet nëse një familjar bie në kontakt me atë rrjet elektrik. Në të njëjtën linjë qëndron edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka lënë pa vëmendje dhe pa kontroll *respektimin e së drejtës familjare* të cenuar si pasojë e vdekjes së djalit të kërkuesve.

7.4. *E drejta për mjedis të sigurt*, e garantuar në nenin 56 të Kushtetutës. Gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, bazuar edhe në mendimin e ekspertëve, u

vlerësua se linja elektrike ku ka ndodhur aksidenti ishte vendosur në shkelje të dy rregulloreve që standardizojnë largësinë horizontale të përcjellësve elektrikë ajrorë nga banesat dhe se linja ajrore ishte e vendosur pa leje ndërtimi. Gjatë gjykimit në gjykatën e apelit është kryer një tjetër akt ekspertimi elektrik, sipas të cilit linja elektrike nuk ishte e sigurt. Gjykata e apelit ka cenuar *të drejtën për të pasur mjedis të sigurt* nga kontakti elektrik me linjën 10 kV kur nëpërmjet arsyetimit të vendimit nuk ka pranuar mendimin e dy ekspertëve, sipas të cilëve lidhja shkak-pasojë nuk do të ndodhte nëse linja elektrike do të ishte vendosur 10 metra larg pallatit, në respektim të largësisë horizontale të përcjellësit ajror elektrik me banesat (sipas nenit 11.2. të rregullores së Kushteve të Projektimit ose 6.5 metra larg pallatit sipas nenit 5.5. të rregullores së Sigurimit Teknik). Gjithashtu, i njëjti qëndrim vërehet në vendimin standard të Gjykatës së Lartë.

8. *Subjekti i interesuar, OSHEE-ja*, ka prapësuar si vijon:

8.1. *Pretendimet për të drejtën për proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë, për një gjykim të drejtë, të së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk janë të bazuara*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zhvilluar një hetim të plotë dhe kanë respektuar parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Lartë, me të drejtë, ka vendosur mospranimin e rekursit në kushtet kur shkaqet e parashtruara lidheshin me vlerësimin e provave.

8.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së jetës jo vetëm parashtrohet për herë të parë në ankimin kushtetues individual*, por kërkuesit nuk legjitimohen, pasi kjo e drejtë bën pjesë në kategorinë e lirive dhe të drejtave vetjake. E drejta e jetës, referuar nenit 21 të Kushtetutës, lidhet drejtpërdrejt me individin që e gëzon dhe nuk mund të kërkohet përveçse nga ai që e gëzon.

8.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për një mjedis të sigurt gjithashtu parashtrohet për herë të parë në Gjykatë*. Pavarësisht kësaj, pretendimi është i pabazuar, sepse kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument kushtetues dhe argumentet e tyre kanë të bëjnë me vlerësimin e provave e me interpretimin e ligjit. Nga të gjitha provat është arritur në përfundimin se i ndjeri ka humbur jetën, por nuk është provuar se kjo ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të rregullave nga OSHEE-ja. Për rrjedhojë, që të kërkohet shpërblimi i dëmit duhet të ekzistojnë të gjitha elementet në mënyrë kumulative (dëmi/lidhja shkakësore/veprimi ose mosveprimi/faji), ndaj në këtë rast mungon përgjegjësia e organit publik.

9. *Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit*, ka prapësuar si vijon:

9.1. *Pretendimet për të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:*

9.1.1. *Së drejtës së aksesit në gjykatë, për një gjykim të drejtë, të së drejtës së ankimit dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm iu kanë dhënë përgjigje të arsyetuara çdo kërkitimi për shpërblimin e dëmit. Interpretimi dhe zbatimi i ligjit nuk rezulton të jenë arbitrarë dhe nuk paraqesin probleme në aspektin kushtetues. Edhe Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit të saj për mospranimin e rekursit u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve.*

9.2. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së jetës është i pabazuar, pasi Gjykata e Apelit Gjirokastër, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka bërë një vlerësim të ri të provave dhe të fakteve, si dhe, bazuar në aktet e ekspertimit, ka vlerësuar për rrëzimin e kërkesëpadisë. Ndryshe nga sa pretendojnë kërkuessit, nuk rezulton të ketë shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit të kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së për të drejtën e jetës. Ngjarja ka ndodhur si pasojë e kontaktit të pavullnetshëm/aksidental me linjën elektrike. Sistemi ligjor e rregullator në sektorin e energjisë ka qenë funksional dhe i zbatueshëm, si dhe të gjitha organet përgjegjëse, duke përfshirë edhe prokurorinë, kanë kryer hetimet e tyre. Në këto kushte, nuk ekziston lidhja e nevojshme e shkakësore ndërmjet veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të palës së paditur/OSHEE-së dhe pasojës së ardhur.*

9.3. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për të pasur familje dhe për një mjedis të sigurt, kërkuessit nuk i kanë ngritur gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër dhe as në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, këto pretendime nuk mund të merren në shqyrtim, pasi nuk janë ngritur në çdo shkallë të gjykimit.*

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessve

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat

negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Gjykata vëren se kërkuessit, në cilësinë e trashëgimtarëve, kanë ngritur kërkesëpadi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga humbja e jetës së djalit të tyre, proces i cili ka përfunduar me mospranimin e rekursit të tyre nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, kërkuessit justifikojnë interesin në çështjen kushtetuese të parashtruar në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

12. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.05.2024; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata verifikon nëse për pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuessit i kanë shteruar mjetet e zakonshme të ankimit, pra nëse i kanë ngritur ato paraprakisht përpara gjykatave të zakonshme.

13. Gjykata vëren se kërkuessit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm të vënë në lëvizje prej tyre nëpërmjet padisë, ankimit dhe rekursit, duke i shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion nga ana formale. Për sa i takon substancës së pretendimeve, kërkuessit ankohen edhe për procesin gjyqësor të zhvilluar nga Gjykata e Lartë, për të cilin i vetmi mjet juridik në dispozicion është ankimi kushtetues individual. Në lidhje me pretendimin *për një mjedis të sigurt*, të garantuar në nenin 56 të Kushtetutës, Gjykata vëren se nga përmbajtja e rekursit kërkuessit nuk e kanë parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të shprehur këtë pretendim, sikurse e kanë paraqitur në ankimin kushtetues individual dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson të mos e marrë në shqyrtim, sepse ata nuk i kanë shteruar mjetet juridike efektive, gjë që është prapësuar me të drejtë edhe nga subjektet e interesuara.

14. Kërkuessit legjitimohen edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 19.02.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuessit kanë parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës së jetës, për familje, të së drejtës së aksesit, të gjyqësorit të drejtë, si dhe të ankimit substancial dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

16. Gjykata vëren se për pretendimin për cenimin e së drejtës për familje, të garantuar në nenin 53 të Kushtetutës, nga përmbajtja e rekursit kërkuesit e kanë parashtruar dhe argumentuar këtë pretendim të lidhur në substancë me cenimin e së drejtës së jetës të familjarit të tyre, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme nga organet përgjegjëse, gjë që ka sjellë edhe shuarjen e marrëdhënies prind-fëmijë dhe, për këtë arsye, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për jetë familjare lidhet me kërkimin kryesor të tyre për cenimin e së drejtës së jetës, prandaj argumentet e paraqitura do të mbahen në konsideratë gjatë analizës së tij.

17. Gjithashtu, kërkuesit kanë parashtruar pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për aksesit, gjykimin të drejtë, ankimit substancial dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi, sipas tyre, vendimi i gjykatës së apelit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili i ka dhënë fund procesit gjyqësor, nuk i kanë dhënë përgjigje kërkimit se cili institucion ishte përgjegjës për zbatimin e rregullave për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, moszbatimi i të cilave ka sjellë humbjen e jetës së familjarit të tyre. Gjykata vëren se, në thelb, të gjitha pretendimet e mësipërme, të cilat lidhen me procesin e rregullt ligjor, janë renditur nga kërkuesit me të njëjtat argumente që analizojnë cenimin e së drejtës së jetës.

18. Lidhur me të drejtën e jetës, e cila ka qenë objekt i gjykimin në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, evidentohet se neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e personit mbrohet me ligj, duke vendosur në këtë mënyrë detyrime pozitive, në radhë të parë, për ligjvënësin që të parashikojë rregulla ligjore për mbrojtjen e jetës së individit dhe më pas për gjykatat e zakonshme, të cilat kanë përgjegjësinë e verifikimit nëse detyrimet ligjore për mbrojtjen e jetës janë përmbushur nga institucionet shtetërore të ngarkuara nga ligji. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuesve për cenimin e së drejtës e jetës dhe së drejtës për jetë familjare lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar, vlerëson që ato të shqyrtohen në themel në drejtim të së drejtës së aksesit dhe arsytimit të vendimit gjyqësor, si aspekte të procesit të rregullt ligjor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës. Ky i fundit gjithashtu parashikon se të drejtat e njohura me Kushtetutë (ku përfshihet edhe e drejta e jetës), nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

19. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja e paraqitur do të vlerësohet në këndvështrim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

20. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk ka arsyetuar se përse OSHEE-ja është lejuar të shfrytëzojë rrjetin elektrik në kundërshtim me çdo normë ligjore dhe nëse ky institucion është përgjegjës për pasojën e ardhur. Gjykata e apelit ka heshtur për të gjitha kërkimet, për më tepër për kërkimin kryesor, për cenimin e së drejtës së jetës të familjarit të kërkuesve. Edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij, megjithëse i ka listuar shkaqet e rekursit, ka përsëritur shkeljet e gjykatës së apelit, pasi nuk ka arsyetuar për kërkimin thelbësor. Gjykata e Lartë, duke u bazuar edhe në natyrën e pretendimeve (natyrë kushtetuese), duhet të jepte përgjigje të arsyetuara, duke mbajtur në konsideratë se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar kërkimet si të bazuara në ligj, ndryshe nga gjykata e apelit.

21. Subjekti i interesuar, OSHEE-ja, ka prapësuar se pretendimet janë të pabazuara, pasi kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë argument kushtetues dhe se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave. Nga të gjitha provat e paraqitura nuk është provuar se humbja e jetës ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të rregullave nga OSHEE-ja. Gjykata e Lartë, me të drejtë, ka vendosur mospranimin e rekursit në kushtet kur shkaqet e parashtruara lidheshin me vlerësimin e provave.

22. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara çdo kërkimi për shpërblimin e dëmit dhe se interpretimi e zbatimi i ligjit nuk rezulton të jetë arbitrarë dhe nuk paraqesin probleme në aspektin kushtetues. Gjatë shqyrtimit të çështjes nuk rezultoi të kishte shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit në kuptim të nenit 21 të Kushtetutës dhe nenit 2 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e jetës. Ngjarja ka ndodhur si pasojë e kontaktit të pavullnetshëm/aksidental me linjën elektrike.

23. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026, nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata ka pohuar se e drejta e aksesit ka për qëllim të garantojë shtetasit që pretendimet e tyre për cenimin e të drejtave kushtetuese e ligjore, përfshirë rastet kur cenimi vjen nga një akt i administratës shtetërore, do të marrin përgjigje nga autoritetet përkatëse

shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve shtetërore në të drejtat e individit ose të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një instancë që garanton pavarësinë dhe paanësinë gjatë procesit të shqyrtimit (*shih vendimet nr. 38, datë 19.03.2026; nr. 70, datë 24.11.2016; nr. 10, datë 04.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Sipas Gjykatës, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit* që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to (*shih vendimet nr. 10, datë 13.03.2025; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 11, datë 10.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se standardi i arsytimit është i lidhur edhe me respektimin e të drejtave të tjera kushtetuese, siç është e drejta e aksesit në gjykim dhe e drejta e ankimit efektiv (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ripohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 3, datë 21.01.2025; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata do të verifikojë nëse kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare për kërkimin për dëmin e shkaktuar nga humbja e jetës së familjarit të tyre, duke shqyrtuar nëse është analizuar në mënyrë të mjaftueshme dhe të

nevojshme nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në drejtim të parashikimeve ligjore, si dhe nëse vendimi i Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet kushtetuese të arsyetimit.

29. Gjykata vëren se në kohën e humbjes së jetës të familjarit të kërkuesve, rregullat për sigurinë e njerëzve nga rreziku elektrik dhe masat që duhet të merrte personi juridik për instalimet elektrike parashikoheshin në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, të ndryshuar (*ligji nr. 8734/2001*). Sipas këtyre parashikimeve ligjore, pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike duhej të plotësonin kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në rregulloret në fuqi për projektimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe vlerësimin e konformitetit (pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 8734/2001). Pajisjet, instalimet dhe rrjetet elektrike përpara vënies në shfrytëzim duhej të kontrolloheshin në aspektin e sigurisë së jetës së njerëzve, të kafshëve shtëpiake ose të vlerave materiale nga specialisti elektrik i caktuar posaçërisht nga subjekti furnizues me energji elektrike (pika 1 e nenit 6 të ligjit nr. 8734/2001). Personi juridik që përdor pajisje ose instalime elektrike merr të gjitha masat për të kryer kontrollin teknik periodik të çdo pajisjeje ose instalimi, sipas afateve të përcaktuara në rregulloret e sigurimit teknik për pajisjet dhe instalimet elektrike të miratuara nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (pika 2 e nenit 6 të ligjit nr. 8734/2001).

30. Gjithashtu, referuar legjislacionit të kohës, Gjykata konstaton se detyrimet kryesore që lidheshin me operatorët e shpërndarjes së energjisë elektrike rregulloheshin nga ligji nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” (*ligji nr. 9072/2003*). Në shkronjën “c” të nenit 43 të ligjit nr. 9072/2003 parashikohej se shoqëritë e shpërndarjes së energjisë elektrike janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e mjediseve dhe të pajisjeve, në përputhje me kërkesat teknike. Në Republikën e Shqipërisë prej vitit 2007, subjekti i interesuar, OSHEE-ja, i themeluar në formën e shoqërisë anonime, është subjekti përgjegjës që vepron në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Për më tepër, referuar edhe statutit të tij, objekt i aktivitetit të tij (neni 4 i statutit), mes të tjerash, ka edhe: (i) operimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të mjediseve dhe të pajisjeve në administrimin e tij në përputhje me kërkesat teknike; (ii) menaxhimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; (iii) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

31. Në vijim, Gjykata vëren se rregullat teknike në drejtim të distancave që duhet të respektohen në vendosjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike janë të parashikuara në dy rregullore specifike të cilave iu janë referuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në vendimet e tyre. Konkretisht, në pikën 11.2. të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit parashikohet se në vendet e banuara, linjat elektrike ajrore (në gjendje të qetë, të pamënjanuara nga ndikimi i erës) duhet të jenë 10 metra larg nga objektet e banimit. Ndërsa në pikën 5.5. të rregullores së Sigurimit dhe të Shfrytëzimit Teknik parashikohet se largësia horizontale nga përcjellësit anësorë për zhvendosjen më të madhe të përcjellësve të linjës deri në pjesët me të

afërta të objekteve që ndodhen ose ndërtohen duhet të jetë jo më e vogël se 2 metra për tensionin deri 20 kV.

32. Sikurse u parashtrua në rrethanat e këtij rasti (*shih paragrafët 1-2 të vendimit*), çështja në shqyrtim lidhet me humbjen e jetës së djalit të kërkuesve, si pasojë e ushtrimit të një aktiviteti që përbën burim rreziku të shtuar, konkretisht shpërndarja e energjisë elektrike. Kërkuesit i janë drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm duke paraqitur pretendimin për shpërblimin e dëmit që lidhej me humbjen e jetës së familjarit të tyre, si rezultat i mosveprimit të paligjshëm të organeve shtetërore për të garantuar sigurinë e jetës. Pretendimi është me natyrë kushtetuese, sepse lidhet me të drejtën e jetës të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së. Konkretisht, pretendimi i kërkuesve lidhet me detyrimin pozitiv të shtetit për të marrë masat e nevojshme për të përcaktuar faktet dhe përgjegjësinë e personave përgjegjës, si dhe për t'i ofruar dëmshpërblimin e duhur viktimës në rastin kur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit ka ardhur si rezultat i neglizhencës së shtetit.

33. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet, ka vlerësuar se humbja e jetës ka ndodhur për shkak të kontaktit të padëshiruar me përcjellësin ajror elektrik, pasi OSHEE-ja ka vendosur këta përcjellës në rrugën “Turizëm-Kanali i Çukës” në shkelje të rëndë të distancave të lejuara me objektet e banimit. Humbja e jetës të të afërmit të kërkuesve (lidhja shkakësore) ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë, e menjëhershme e vendosjes së linjës elektrike të tensionit 10 kV në shkelje të nenit 11.2. të rregullores së Kushteve Teknike të Projektimit, që parashikon se në vendet e banuara linja elektrike ajrore (në gjendje të qetë) duhet të jetë 10 metra larg nga objektet e banimit dhe në rastin konkret ka qenë 1.98-2 metra. Gjithashtu, është shkelur edhe pika 5.5. e rregullores së Sigurimit Teknik, që parashikon se largësia horizontale nga përcjellësi anësor në zhvendosjen me të madhe të përcjellësve deri në pikën më të afërt të objekteve duhet të jetë jo më e vogël se 2 metra për tensionin deri në 20 kV (*shih faqet 5 dhe 10 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*). Ndërsa Gjykata e Apelit Gjyrokastër, megjithëse ka vlerësuar në të njëjtën linjë, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë, për shkeljen e parashikimeve të rregulloreve teknike të sipërcituara, ka arritur në përfundimin se distanca 2 metra largësi e linjës ruhet nëse ajo nuk pëson lëkundje, si pasojë e erës dhe nga kërkuesit/palë paditëse nuk është provuar nëse ditën e ngjarjes ka pasur erë, e cila mund të ketë bërë që distanca e linjës së zhvendosur të ishte më e vogël se 2 metra. Sipas gjykatës së apelit, edhe nëse do të zbatoheshin largësitë dhe do të kishte fryrë erë, që do të zhvendoste linjën në distancën 2 metra (distanca minimale), përsëri do të kishte ndodhur aksidenti për shkak të pakujdesisë së viktimës duke vendosur në përfundim rrëzimin e kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit (*shih faqet 15-16 të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër*). Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjatë gjykimit të çështjes në dhomën

e këshillimit, ndonëse gjendej përpara një pretendimi me natyrë kushtetuese (e drejta e jetës), ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante shkaqe të parashikuara nga ligji.

34. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata vëren se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të përcaktuar pasjen ose mungesën e përgjegjësisë civile nga dëmet e shkaktuara nga linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike janë fokusuar në analizën e distancave fizike të linjës elektrike nga zona e banuar sipas dy rregulloreve teknike të sipërpërmendura. Nga vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë rezulton se, ndonëse kjo gjykatë ka pranuar ekzistencën e mosrespektimit të disa standardeve teknike në lidhje me vendosjen e linjës elektrike, përsëri ka arritur në përfundimin e mungesës së përgjegjësisë së OSHEE-së. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se gjykata e apelit nuk ka evidentuar detyrimet pozitive, ndërkohë kur sipas jurisprudencës së Gjykatës rezulton se detyrimi pozitiv i shtetit jo vetëm duhet të ekzistojë në teori, por duhet të zbatohet edhe në praktikë, duke mundësuar përcaktimin e çdo përgjegjësie dhe marrjen e çdo mjeti juridik civil të përshtatshëm (*shih vendimet nr. 10, datë 10.03.2026; nr. 63, datë 23.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk ka një analizë të detyrimeve pozitive që burojnë nga legjislacioni përkatës i sipërcituar (ligjet nr. 8734/2001 dhe nr. 9072/2003) për subjektin që shpërndan energjinë elektrike lidhur me mirëmbajtjen ose kontrollin periodik të linjave të shpërndarjes së energjisë elektrike, që përbën një veprimtari të rrezikshme të parashikuar në nenin 622 të Kodit Civil, si një nga rastet e përgjegjësisë pa faj. Veprimtaria e shpërndarjes së energjisë elektrike kërkon marrjen e masave konkrete administrative dhe teknike që lidhen jo vetëm me lejet për vendet ku vendosen linjat elektrike, por edhe me kontrole të vazhdueshme dhe/ose periodike me natyrë mirëmbajtjeje, si dhe pajisjen me shenjat e nevojshme për të treguar rrezikshmërinë e tyre. Në këtë drejtim, gjykata e apelit nuk ka dhënë një shpjegim të plotë dhe bindës se përse shkelja e standardeve të tjera teknike të vendosura për të garantuar sigurinë në raport me objektet e banimit, e pranuar edhe nga ajo vetë në arsyetimin e vendimit gjyqësor, nuk është konsideruar e rëndësishme për përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të interesuar. Kjo gjykatë në vendimin e saj nuk ka analizuar se përse konkurrimi i pakujdesisë së viktimës, në kushtet e një përgjegjësie të përzier e përjashton totalisht nga përgjegjësia subjektin e interesuar për shpërblimin e dëmit. Gjykata e apelit është bazuar vetëm në hipoteza nëse do të frynte erë dhe i ka kaluar barrën e provës kërkuar që nuk kanë provuar nëse atë ditë frynte ose jo erë. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka interpretuar në mënyrë formale dhe *strictu sensu* kuadrin ligjor duke u mbështetur në dy rregulloret teknike, interpretim i cili nuk ka marrë në konsideratë qëllimin e akteve ligjore duke nxjerrë një përfundim hipotetik e duke përjashtuar *apriori* nga përgjegjësia institucionet që operojnë në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike.

36. Për sa i takon vendimit të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji, Gjykata vlerëson se vendimi është mbështetur në një arsyetim të përgjithshëm e formal, i cili është kufizuar në pohime standarde për respektimin e normave procedurale dhe zbatimin e ligjit material. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të pretendimit të kërkuarve që interpretimi i kuadrit ligjor nga gjykata e apelit mohonte thelbin e së drejtës së jetës, për sa u takon detyrimeve pozitive të shtetit/institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave për shpërndarjen e energjisë elektrike si fushë që përbën burim rreziku të shtuar edhe për jetën e individit me impakt dhe pasoja të ndjeshme dhe të drejtpërdrejta në sigurinë publike. Në këto rrethana, mospranimi i rekursit të kërkuarve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me shqyrtimin *de plano* të çështjes dhe me arsyetimin e kufizuar se shkaqet e rekursit nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa i dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit me natyrë kushtetuese, për të drejtën e jetës, ka vënë në dyshim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore kushtetuese të kërkuarve, si pasojë e mosmarrjes së masave nga institucioni përgjegjës në përputhje me parashikimet ligjore.

37. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*.

38. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarve është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-709, datë 19.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 06.05.2026

Shpallur më 25.06.2026

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuësve Dhimë Qurku, Anastasia Qurku, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 20-2019-984/413, datë 16.12.2019 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë; nr. 00-2025-709, datë 19.02.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, për shkak se ajo gjykatë nuk kishte mbajtur qëndrim të arsyetuar për pretendimin e kërkuësve të parashtruar në rekurs në lidhje me arsyet e dhëna nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë për rrëzimin e padisë.

3. Pakica vlerëson se nuk është në rolin e Gjykatës të korrektojë çdo gabim në vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, por të ndërhyjë vetëm në ato raste kur vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk përmbush kriteret e një gjykimi të drejtë. Si rregull, vlerësimi i provave dhe i fakteve të çështjes u përket gjykatave të zakonshme dhe, në rastin konkret, ato kanë arsyetuar mjaftueshëm për sa i përket lidhjes shkakësore dhe shkakut determinant si kusht pa të cilin nuk ka përgjegjësi civile të të paditurit. Gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se janë respektuar kushtet minimale teknike për largësinë horizontale të përcjellësve të rrymës elektrike nga fasada e pallatit, por ngjarja ka qenë rast fatkeq për shkak të pakujdesisë së viktimës që ka sjellë ardhjen e pasojës së dëmshme. Kjo pasi viktimë, duke mbajtur në dorë një tub prej metali rreth 6 metra të gjatë, është hasur në linjën elektrike dhe për këtë shkak ka ardhur pasoja. Ekzistenca e ndonjë tabele paralajmëruese në shtyllën e tensionit (siç pretendojnë kërkuësit) nuk është e qartë sesi do të ndikonte në shmangien e pasojës së dëmshme.

4. Idealisht që dëmi të shmangej do të duhej që të mos kishte fare linjë ajrore me përcjellës rryme të zhveshur në një zonë të banuar, por kjo nuk është çështja në këtë rast. Çështja është nëse instalimi, ashtu siç ishte dhe siç mundësonte stadi i zhvillimit të infrastrukturës energjetike në atë kohë, ka qenë sipas parametrave minimalë teknike, për aq sa e lejonte mjedisi urban në të cilin kalonte përcjellësi. Duke qenë se është respektuar distanca sipas rregullores teknike (minimumi 2 metra) dhe njëkohësisht bëhet fjalë për një linjë furnizimi me energji elektrike që kalon në një zonë të banuar, ku në të dyja anët e rrugës janë ndërtuar ndërtesa të larta pas viteve '90, duket se nuk ka pasur mënyrë tjetër për furnizim me energji elektrike përveç infrastrukturës që ishte në vend në atë kohë. Jam i mendimit se gjykatat

e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar mjaftueshëm kur kanë arritur në përfundimin se pas marrjes edhe të mendimit të specializuar të ekspertëve, dëmi ka ardhur për shkak të pakujdesisë së vet viktimës dhe jo për shkak të mosrespektimit të ndonjë kushti teknik. Gjykata e apelit ka vlerësuar përfundimet e ekspertëve dhe ka arritur në këtë përfundim. Gjykatat e faktit, duke konstatuar respektimin e kriterëve minimale të rregulloreve të sigurimeve teknike dhe duke mbetur ardhja e pasojës vetëm te fakti i gjatësisë së tubit që kishte në duar viktimë e që solli pasojën e dëmshme, vlerësoj se janë përmbushur kriteret e nenit 622 të Kodit Civil për përjashtimin e OSHEE-së nga përgjegjësia, në rastin konkret. Meqenëse thelbi i çështjes lidhet me vlerësimin e provave dhe Gjykata e Lartë nuk ka juridiksion për vlerësimin e tyre, mendoj se vendimi i asaj gjykate është marrë konform dispozitave përkatëse procedurale kur ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se ai nuk ngrinte shkaqe sipas nenit 472 të KPC-së, ndaj nuk kishte vend për cenimin e kësaj vendimmarrjeje dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë.

Asim Vokshi: Anëtar